




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.47/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 6 të Rregullores nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Emërohet Komisioni për rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për gjyqtar në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, në përbërjen si në vijim:
 1. Ragip Namani, gjyqtar në Gjykatën Supreme/kryetar i komisionit;
 2. Arjeta Sadiku, anëtare e KGJK-së/anëtare e komisionit;
 3. Bujar Muzaqi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
 4. Sahit Sylejmani, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme/anëtar rezervë, si dhe
 5. Avni Mehmeti, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë i komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 22 shkurt 2024, ka shpallur konkurs për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, si dhe ka themeluar Komisionin për Rekrutim.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në rast të ankesave eventuale të kandidatëve për gjyqtar ndaj vendimeve të Komisionit për Rekrutim, në këtë takim ka emëruar edhe komisionin për rishqyrtim, konform nenit 6 të Rregullores nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve. Nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.